

VENDIM
Nr. 31, datë 19.1.2022

PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE TEK AGJENCIA SHETËRORE E KADASTRËS, TË NJË PJESE TË PASURISË 8/114, ZONA KADASTRALE 8330, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 818, DATË 6.12.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të mjediseve të katit të katërt teknik, me sipërfaqe ndërtimi 1 132 (një mijë e njëqind e tridhjetë e dy) m² dhe të katit të pestë teknik, me sipërfaqe ndërtimi 1 132 (një mijë e njëqind e tridhjetë e dy) m², të pronës me emërtimin “Dega e Tatimeve, Tiranë”, pjesë të pasurisë 8/114, zona kadastrale 8330, Tiranë, sipas planimetrive bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim ushtrimin e funksioneve administrative të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

2. Prona me emërtimin “Dega e Tatimeve, Tiranë”, e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 818, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, të ndryshuar.


3. Vendimi nr. 536, datë 4.8.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjediseve të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të cilat i kalojnë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Dega e Tatim-Taksave, Tiranë”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLANIMETRIA E KATIT TE PESTE NE KUOTEN +23.97



	
INSTITUTI I DREKTORISE SE REKONSTRUKSIONE TATIMORE DISEA TATIM TANKAVE TRAKE	
Projektimi: PLANIMETRIA E KATIT TE PESTE	
Kena: +23.97	Skala: 1:200
Data: 22.11.2021	
Shprehim Komiteti	

PLANIMETRIA E KATIT TE KATERIT NE KUOTEN +19.55



		INSTITUTI E INGENJERISE DHE ARKITEKTURE ME TE TITULIMET DEDIKUA TITULIM TËNKSIMORË TËNKSIMORË	
		PLANIMETRIA E KATIT TE KATERIT	
Data: 22.11.2021	Orari: 11:32:00	Skala: 1:200	Shprehim Komiteti: 